



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura III
Sesioni vjeshtor

Seancë plenare e Kuvendit

P- 037

Prishtinë, më 25 shtator 2008, në orën 10:00

Ndërtesa e Kuvendit, sala e seancave plenare.

PROCESVERBAL

**I SEANCËS PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË MBAJTUR
MË 25 SHTATOR 2008**

Seancën e kryesoi **Jakup Krasniqi**, Kryetar i Kuvendit, kurse i ndihmoi **Eqrem Kryeziu**, anëtar i Kryesisë.

Kryetari konstatoi se në seancë janë të pranishëm 92 deputetë dhe e deklaroi të hapur punën e saj.

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me grupet parlamentare, në pajtim me rregullat 6.2 dhe 23 të Rregullores së Punës së Kuvendit, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për seancën e sotme plenare.

Ai propozoi që pika e 3-të të hiqet nga rendi i ditës dhe të rishpallet konkursi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit. Ai kërkoi nga kryetarët e grupeve parlamentare të deklarohen për këtë propozim.

Kryetarët e grupeve parlamentare të PDK-së, të LDK-së, të AKR-së, të “7+” dhe të SLS-së deklaruan se e mbështesin propozimin e kryetarit që pika e 3-të të hiqet nga rendi i ditës, ndërsa përfaqësuesit e grupit parlamentar të LDD-së dhe të AAK-së ishin kundër heqjes së kësaj pike nga rendi i ditës.

Pas deklarimit të kryetarëve të grupeve parlamentare, Kryetari e hodhi propozimin në votim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----45;
Kundër-----15,
Abstenime-----2.

Kryetari konstatoi se pika e 3-të – Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit, hiqet nga rendi i ditës dhe rishpallet konkursi për zgjedhjen e Avokatit të Popullit .

Ai i njoftoi deputetë se, ndërkohë, Komisioni për Buxhet dhe Financa i ka rekomanduar Kuvendit që ta radhit në rend dite të kësaj seance - Shqyrtimin e Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për lejimin e mjeteve për Ministrinë e Forcës së Sigurisë, të cilin e hodhi në votim. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- shumica absolute,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për lejimin e mjeteve për Ministrinë e Forcës së Sigurisë radhitet për seancën e sotme.

Kryetari i njoftoi deputetët me vendimin e Grupit Parlamentar të Lidhjes Demokratike të Kosovës për emërimin e deputetit Naser Osmani për anëtarë të Komisionit për Buxhet dhe Financa në vend të deputetit Armend Zemaj.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë

R e n d d i t e:

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 18 shtator 2008,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës,
4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armët,
5. Shqyrtimi i propozimit për formimin e Komisionit ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media, dhe
6. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për lejimin e mjeteve për Ministrinë e Forcës së Sigurisë.

1. Miratimi i Procesverbalit të seancës plenare të mbajtur më 18 shtator 2008

Procesverbali i seancës plenare të mbajtur më 18 shtator 2008, u miratuan pa vërejtje.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputeti **Naser Rugova** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me ndarjen e mjeteve 20% për ish-punëtorët e ndërmarrjeve të privatizuara.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rugova**.

Deputeti **Naser Rugova** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me rishikimin e rasteve të kontestuara gjatë privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rugova**.

Deputeti **Hydajet Hyseni** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me djegien e dokumentacionit të ndërmarrjeve të privatizuara.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Hyseni**.

Deputeti **Hydajet Hyseni** i parashtroi pyetje ministres së Energjetikës dhe të Minierave lidhur me ndodhitë në gazsjellësin përgjatë rrugës Kastriot – Prishtinë dhe ndikimi i tij në zvogëlimin e shpenzimeve të rrymës elektrike në Prishtinë.

Ministrja **Justina Pula** nuk ishte e pranishme në seancë. Përgjigjja mbeti për seancën e radhës.

Deputetja **Myrvete Pantina** i parashtroi pyetje Kryeministrit **Hashim Thaçi** lidhur me mundësitë e veprimt të Qeverisë së Kosovës për t'u ndërprerë shkatërrimi i fabrikës “Llamkos” në Vushtri.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Pantina**.

Deputetja **Myrvete Pantina** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave se në cilat ndërmarrje publike menaxherët i marrin pagat më të mëdha se sa zyrtarët më të lartë të shtetit të Kosovës?

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Pantina**.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë pse nuk po vihet në funksionim Instituti i Onkologjisë në Prishtinë?

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me posedimin e statistikave të ministrisë për nivelin e suksesit të trajtimeve mjekësore jashtë vendit.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Syla**.

Deputetja **Gjylnaze Syla** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me suspendimin e drejtorit të Doganave, Naim Huruglica dhe kthimin e tij në punë.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Syla**.

Deputetja **Gjylnaze Sylja** i parashtroi pyetje ministrit të Ekonomisë dhe të Financave lidhur me vendimin e Qeverisë së Kosovës për lirim të ndëshkimeve për kompanitë që nuk ia kanë paguar borxhin Administratës tatimore të Kosovës.

Ministri **Ahmet Shala** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Sylja**.

Deputetja **Suzanë Novobërdaliu** i parashtroi pyetje ministrit të Shëndetësisë lidhur me raportin e Auditorit të Përgjithshëm për tregtimin e paligjshëm të produkteve medicinale dhe për gjendjen në QKUK.

Ministri **Alush Gashi** iu përgjigj pyetjes së deputetes **Novobërdaliu**.

Deputeti **Naim Rrustemi** i parashtroi pyetje ministrit të Mjedisit dhe të Planifikimit Hapësinor lidhur me përbërjen kimike të materieve helmuese të vendosura (përkohësisht) në Mitrovicë.

Ministri **Mahir Yagcilar** iu përgjigj pyetjes së deputetit **Rrustemi**.

Pyetjet të cilat nuk u parashtruan në këtë seancë për shkak të kohës së kufizuar (50 minuta), procedohen në seancën e radhës.

3. Shqyrtimi i parë i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Kryetari ftoi përfaqësuesin e Qeverisë ta prezantojë Projektligjin para deputetëve të Kuvendit.

Zëvendëskryeministri **Ramë Manaj**, në emër të Qeverisë, tha se qëllimi i Projektligjit për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës është rregullimi ligjor i dhënies së dekoratave nga Presidenti që u ndahen qytetarëve të Kosovës, qytetarëve të huaj, si dhe personave juridikë që shquhen për merita të veçanta ndaj Republikës së Kosovës dhe interesave kombëtare të vendit.

Me këtë projektligj synohet të rregullohet në detaje dhënia e dekoratave nga Presidenti i vendit që u jepen individëve dhe institucioneve.

Projektligji është përgatitur nga Zyra për shërbime të ndihmës juridike pranë Zyrës së Kryeministrit, në bashkëpunim me Zyrën e Presidentit dhe është harmonizuar me ligje të BE-së, standardet e përcaktuara sipas aquit komunitare.

Me miratimin e këtij projektligji zbatohet në mënyrë të përpiktë neni 84.28 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Kryetari hapi debatin lidhur me Projektligjin për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës

Opinione, vërejtje dhe sugjerime dhanë: në emër Komisionit për Legjislacion dhe Gjyqësi dhe të Grupit Parlamentar të PDK-së, Bahri Hyseni, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Haziri, në emër të Grupit Parlamentar të AKR-së, Riza Smaka, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Gjylnaze Sylja, në emër të Grupit Parlamentar të LDD-së, Naser Rugova, në emër të Grupit Parlamentar “7+”, Zylfi Merxha, në emër të Grupit Parlamentar të SLS-së, Bojan Stojanoviq, si dhe deputetët Numan Baliq, Emrush Xhemajli, Hydajet Hyseni, Ardian Gjini,

Ibrahim Gashi, Ramadan Avdiu, Adem Salihaj, Berim Ramosaj, Naim Maloku, Memli Krasniqi, Ismet Beqiri, Gani Koci, Gani Buçinca dhe Agim Veliu, të cilat janë bashkangjitur në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, Kryetari e hodhi në votim miratimin e këtij projektligji. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----30,
Kundër-----39,
Abstenime-----9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nuk e miratoi, në parim, Projektligjin për ndarjen e dekoratave nga Presidenti i Republikës së Kosovës.

4. Shqyrtimi i dytë i Projektligjit për armët

Kryetari i njoftoi deputetët me procedurat e shqyrtimit të këtij projektligji. Komisioni për Punë të Brendshme dhe Siguri e ka shqyrtuar Projektligjit për armët dhe i ka rekomanduar Kuvendit që t'ia kthejë Qeverisë.

Ai ftoi përfaqësuesin e komisionit raportues ta marrë fjalën.

Kryetari i Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri, **Rrustem Mustafa**, tha se pas leximit të parë të këtij projektligji Komisioni ka mbajtur dëgjim publik, nga i cili ka marrë disa propozime. Pas kësaj seance dëgjimore, e kemi bërë edhe një grup të punës, të mbështetur nga UNDP. Pas gjithë asaj pune që kemi bërë, ku është paraparë një numër i madh i amendamenteve për ta përmirësuar këtë projektligj dhe, në marrëveshje me Qeverinë e Kosovës, kemi ardhur në përfundim se më mirë është që projektligji t'i kthehet Qeverisë për rihartim dhe t'ia procedojë Kuvendit si projektligj të ri.

Kryetari e hodhi në votim rekomandimin e Komisionit për Punë të Brendshme dhe Siguri. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----61,
Kundër-----3,
Abstenime-----0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash vendosi që Projektligji për armët t'i kthehet Qeverisë së Kosovës, për rihartim.

5. Shqyrtimi i Propozimit për formimin e Komisionit Parlamentar ad hoc për përzgjedhjen e anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur të Mediave

Kryetari i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në mbledhjen e mbajtur më 16 shtator të këtij viti, me anë të një përfundimi ka kërkuar nga partitë politike, të përfaqësuara në këtë Kuvend, që ta propozojnë nga një anëtar për formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e katër anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media.

Ndërkohë, disa nga partitë politike i kanë propozuar kandidatë e tyre, ndërsa disa ende nuk i kanë propozuar. Ai kërkoi nga ato që tani t'i propozojnë kandidatët e tyre për formimin e këtij komisioni.

Partitë politike, të përfaqësuara në Kuvend, i propozuan kandidatët për formimin e Komisionit ad-hoc për përzgjedhjen e katër anëtarëve në Këshillin e Komisionit të Pavarur për Media.

Kryetari hodhi në votim propozimet e partive politike. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----48,
Kundër-----8,
Abstenime-----9.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

I. Formohet Komisioni Parlamentar ad - hoc për përzgjedhjen e kandidatëve për anëtarë në Këshillin e Komisionit të Pavarur të Mediave, në përbërje:

1. Berat Luzha, nga PDK-ja,
2. Armend Zemaj, nga LDK-ja,
3. Esat Brajshori, nga AKR-ja,
4. Rasim Selmanaj, nga AAK-ja,
5. Synavere Rysha, nga LDD-ja,
6. Myfera Shinik, nga PDDK-ja,
7. Dragisha Miriq, nga SLS-ja,
8. Sadik Idriz, nga Koalicioni VAKAT,
9. Numan Baliq, nga SDA,
10. Zylfi Merxha, nga PRBK,
11. Xhevdet Neziraj, nga IRDK,
12. Mursel Halili, nga GIG,
13. _____, nga, SNSDKIM,
14. _____, nga SKMS,
15. _____, nga SNS,
16. _____, nga SDA,
17. _____, nga ND,
18. Hafize Hajdini, nga PDAK.

Partitë politike që nuk i kanë propozuar kandidatët e tyre për anëtarë të Komisionit ad hoc, duhet t'i propozojnë me shkrim.

6. Shqyrtimi i Propozimvendimit të Qeverisë së Kosovës për lejimin e mjeteve për Ministrinë e Forcës së Sigurisë

Kryesuesi ftoi përfaqësuesin e Komisioni për Buxhet dhe Financa ta arsyetojë rekomandimin e komisionit lidhur me propozimin e Qeverisë së Kosovës për lejimin e mjeteve për Ministrinë e Forcës së Sigurisë.

Gani Koci tha se në Komision kemi pasur një kërkesë të dt. 9 shtator 2008, për ndarjen e një (1) milion euro për Ministrinë e Forcës së Sigurisë nga linja buxhetore - Fondi për implementimin e statusit. Ne si Komision kemi pas kërkuar që kjo kërkesë të ushtrohet mbi bazë të normave të Ligjit mbi buxhetin për vitin 2008, të dispozitës 8.2 dhe Ministria e Forcës së Sigurisë ka kompletuar të gjithë dokumentacionin mbi bazën e kësaj dispozite të Ligjit. Komisioni, në mbledhjen e djeshme ka miratuar kërkesën Ministrisë së Forcës së Sigurisë, me një ndryshim. Pas kompletimit të dokumentacionit dhe detajizimit të kërkesave, kemi një shumë më të vogël se 1 milion euro, do të thotë është 745.636 euro për këtë pjesë të vitit fiskal që ka mbetur.

Ministri i Forcës së Sigurisë, **Fehmi Mujota**, tha se pajtohet me rekomandimin e Komisioni për Buxhet dhe Financa për mjetet e lejuara për këtë ministri deri në fund të këtij viti kalendarik, të cilat do t'i shpenzojnë me nikoqirllëk për qëllimet dhe destinimet e parashikuara nga ana e ministrisë.

Kryesuesi hodhi në votim kërkesën e Ministrisë së Forcës së Sigurisë. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----68,
Kundër-----0,
Abstenime-----0.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri mori këtë

V E N D I M

Miratohet kërkesa e Ministrisë së Forcës së Sigurisë për miratimin e Planit buxhetor për periudhën shtator-dhjetor 2008, në shumën prej 745.636€.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 13:55 minuta.

Kryetari i Kuvendit
Jakup KRASNIQI

Përgatiti:
Divizioni i Çështjeve Plenare dhe Procedurale